



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE**

**THIRRJE PËR OFERTË**

**Kompani për dizajnim dhe shtyp**

Programi për të drejtat e njeriut, "HUMAN RIGHTIVISM", i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (watchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të cilit ka zhvilluar/hartuar 1 (një) dokument/udhëzues.

EC Ma Ndryshe shpall thirrje përmes së cilës fton, kompanitë/konsorciumet e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për **"Dizajnim, rradhitje dhe shtyp të dokumentit/udhëzuesit"**.

**Kriteret për ofertim:**

Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim:

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit; Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së),
- Çmimi për koston profesionale për dizajn dhe radhitje për copë;
- Çmimin e shtypit për copë (kolor); formati A4; faqet e mbrendshme min.120gr; faqet e kopertinave min.300gr dhe të plastifikuara; dokumenti/ udhëzuesi është rreth 50 faqe; dokument/ udhëzuesi parashikohet të shtypet rreth 100 copë;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe.

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) deri më datë 24.11.2020, ora 16:00 me shënim: **"Dizajnim, rradhitje dhe shtyp të dokumentit/udhëzuesit"**

Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë/konsorciumet, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm kompanitë/konsorciumet fitues do të informohen/kontaktohen.